

Specialist në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

Specialist në Sektorin e Gjeoportalit Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

(Detyrat kryesore paraqiten si rezultat i punës së kryer)

- a. Përgjigjet për të gjitha punimet që lidhen me ndërtimin, mirëmbajtjen, aksesimin dhe funksionimin e Gjeoportalit Kombëtar.
- b. Garanton aksesin e publikut dhe subjekteve të interesuara në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 72/2012.
- c. Merr pjesë në përgatitjen e akteve të nevojshme nënligjore që lidhen me përcaktimin e standardeve, rregullave, procedurave dhe dokumentimin në lidhje me funksionimin e Gjeoportalit Kombëtar nga përvoja ndërkombëtare dhe situata brenda vendit.
- d. Merr pjesë në hartimin e rregullave që lidhen me aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimeve që lidhen me të.
- e. Merr pjesë në zhvillimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të Gjeoinformacionit Kombëtar që ASIG administron.
- f. Merr pjesë në dizejnimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve WebGIS, aplikacioneve mobile, API dhe platformave të ndërveprimit që ASIG administron.
- g. Merr pjesë në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e faqes zyrtare të Web-it ASIG.

DETYRAT TEKNIKE

- a. Siguron përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit sipas rëndësisë dhe Drejtorin e Drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë punës së tij.

- b. Përgatit sipas udhëzimeve të Eprorit Direkt dokumenta teknike në bazë të detyrave kryesore.
- c. Ndjek dizejimin, zhvillimin dhe mirembajtjen e sistemeve WebGIS, aplikacioneve mobile, API dhe platformave të ndërveprimit që ASIG administron.
- d. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin.
- e. Përfaqëson institucionin vetëm në rastet me propozim të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

(Arsim/ përvoja në punë/ të tjera për kategorinë/ klasën/ grupin)

Arsimi: Diplomë “Master profesional” në Teknologji Informacioni/Informatike/Inxhieneri Informatike/ Inxhieneri Informatike dhe Matematike/Informatike Ekonomike /Gjeoinformatike.

Përvoja: Të ketë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse.

Tjetër:

- Të ketë përvojë në zhvillimin e sistemeve GIS, zhvillimin e platformave dhe aplikacioneve të bazuara në GIS.
- Të njohë gjuhë kodimi JAVA Script/ Python ose gjuhë të tjera që përdoren në sistemet e gjeoinformacionit.
- Të njohë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe komunikimit elektronik.
- Të njohë kërkesat e legjislacionit të BE- ë që lidhen me gjeoinformacionin në kuadrin e integritimit të vendit në BE.
- Të njohë platformat e avancuara, PostgreSQL, PostGIS, Openlayers, Geoext, Leaflet, Mapserver, Geoserver, Geo Explore, Mapbox.
- Të njohë mirë gjuhën angleze, edhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 18.09.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës.

- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka).
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja.
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- Të paktën një letër rekomandimi.
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t'u kontaktuar.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.